



**Republika e Kosovës – Republika Kosova**  
**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësa**  
**Izborni Panel za Žalbe i Predstavke**

**Anr. 149/2017**

**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësa (PZAP)**, në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Zyhdi Haziri kryesues, Nenad Lazic dhe Rafet Haxhaj anëtarë, me pjesëmarrjen e zyrtarës së lartë ligjore Florije Krasniqi, duke vendosur përkitazi me ankesën e subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), dega në Prizren, paraqitur kundër subjektit politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), për shkak të vendosjes së panove reklamuese në objekte publike, për Zgjedhjet Lokale që do të mbahen më 22.10. 2017, në seancën e panelit të mbajtur me datë 10.10.2017, mori këtë:

## **V E N D I M**

**KONSTATOHET** tërheqja e ankesës e subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), ZL. A.nr. 149/2017 e datës 09.10.2017.

### **Arsyetim**

Subjekti politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK) ka paraqitur ankesë në PZAP kundër subjektit politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), për shkak të vendosjes së panosë reklamuese në shtyllë elektrike të kandidatit për anëtar të Kuvendit Komunal të Prizrenit nga radhët e subjektit politik LDK, nëpër shtylla elektrike, për Zgjedhjet Lokale që do të mbahen më 22 tetor 2017.

Me datë 10.10.2017, ankuesi ka parashtruar kërkesë për tërheqjen e ankesës me numër: Anr.149/ 2017 të datës 09.10.2017.

PZAP-i, pasi që shqyrtoi kërkesën për tërheqjen e ankesës të ankuesit, në kuptim të nenit 115.1 të LZP -së, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësa**  
Anr.149/2017 më datën 10.10.2017.



**Kryesues i Panelit**  
Zyhdi Haziri